

DEKLARATË ZYRTARE

BOLV GROUP | 02 shkurt 2026

Kompania BOLV GROUP është informuar për disa publikime së fundmi në disa portale online, të cilat përmbajnë akuza të rënda dhe të pavërteta ndaj aktivitetit të saj.

Deklarojmë në mënyrë të qartë dhe të prerë se këto pretendime janë të pavërteta, të pabazuara dhe pa asnjë mbështetje në fakte.

Prej më shumë se 30 vitesh, kompania BOLV GROUP ushtron aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar të gjitha detyrimet ligjore, fiskale dhe rregullatore. Veprimtaria jonë financiare, projektet dhe marrëdhëniet kontraktore i janë nënshtruar vazhdimisht kontrolleve nga institucionet kompetente, me të cilat kemi bashkëpunuar gjithmonë në mënyrë transparente dhe korrekte.

Përhapja e akuzave të tilla, pa prova dhe pa verifikim paraprak, është keqinformuese dhe dëmton jo vetëm kompaninë tonë, por edhe klientët, partnerët, punonjësit dhe klimën e biznesit në tërësi. Në këtë kuadër, rezervojmë të drejtën për të ndjekur të gjitha rrugët ligjore të parashikuara nga ligji për mbrojtjen e reputacionit dhe interesave tona legjitime.

Njëkohësisht, dëshirojmë të sigurojmë klientët dhe partnerët tanë se angazhimi ynë për korrektësi, transparencë dhe profesionalizëm mbetet i pandryshuar.

Nuk do të angazhohemi në polemika publike apo spekulime. Fokusi ynë mbetet vazhdimi i punës sonë me përgjegjësi dhe respekt ndaj besimit që na është dhënë.

Falënderojmë klientët, partnerët dhe bashkëpunëtorët për besimin e vazhdueshëm.

BOLV GROUP

Bordi Drejtues i Kompanisë